

26827

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE

Nr. 26827 Vendimi

V E N D I M
PER REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Sot me date 14/12/2001, une gjyqtaria e Gjykates se Rrethit Tirane, *G. Xuxox*, pasi shqyrtova kerkesen dhe dokumentat e paraqitura nga Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar " B E L L I U " SHPK me ortak te vetem GRAMOZ HASANBELLIU, per regjistrimin si person juridik,

K o n s t a t o v a s e :

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar " B E L L I U " SHPK Berat, me ortak te vetem Z. GRAMOZ HASANBELLIU ka paraqitur kerkesen prane kesaj gjykate per tu regjistruar si person juridik qe fiton zotesine per te vepruar .

Objekti i veprimtarise se kesaj shoqerie do te jete si me poshte :

- Tregtimi me shumice e pakice, import - eksport te artikujve i ndryshem industriale, ushqimore, bujqesore e blegtorale, pijeve alkoolike e freskuese, fruta perime, artikujve te ndryshem te konsumit te gjere, materiale ndertimi dhe hidrosanitare, makineri e pajisje e pjese kembini per to perfshire ato elektrike, elektroshtepijake, etj. ; Servis ; Veprimtari ne fushen e transportit te ndryshem te mallrave dhe udhetareve .

- Shfrytezimi me punime siperfaqesore (kariera) te gurit gelqeror dhe minerale te tjera per materiale ndertimi . Perpunimi ne linja thyerje e fraksionimi per prodhim rere, granil, cakell, etj. Tregtimi i gurit gelqeror dhe minerale te tjera ne gjendje natyrale dhe te perpunuara .

Kapitali i Shoqerise do te jete 100.000 leke . Selia e Shoqerise do te jete tek Ura Vajgurore ne Berat . Kohezgjatja e veprimtarise

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr. 26827/1 Vendimi

VENDIM I GJYQTARIT TE VETEM

Ne Tirane, sot me date 14.06.2002, une gjyqtare Shpresa Cafa, e Gjykates se Rrethit Tirane, pasi studiova kerkesen e paraqitur nga administratori i shoqerise "BELLIU" sh.p.k, z. Gramoz Hasanbelliu, vendimin numer 1 date 18.06.2002 te Ortakut te vetem te kesaj shoqerise, dhe te kontrates se shitjes nr.523/150 date 18.06.2002, te bere perpara noteres Andromaqi Berati per shitjen e kuotave te tapitalit themeltar:

KONSTATOVA SE

Me Vendimin numer 26827 date 14.12.2001, te Gjykates se Rrethit Tirane, eshte vendosur krijimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar te emertuar "BELLIU" sh.p.k. me kapital fillestar 100.000 (njqindmije) leke.

Me vendimin numer 1 date 18.06.2002 te Ortakut te vetem te kesaj shoqerise eshte miratuar kontrata e shitjes nr.523/150 date 18.06.2002, perpara noteres Andromaqi Berati, me te cilen z. Gramoz Hasanbelliu i ka shitur z. Agron Hasanbelliu 100% te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise, me vleren 100.000 (njqindmije) leke .

PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit numer 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare" dhe nenit 24 te ligjit 7667 date 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar" si dhe formaliteteve qe duhen plotesuar :

VENDOSA

- Pranimin e kerkeses
- Depozitimn i vendimit numer 1 date 18.06.2002 te Ortakut te vetem te shoqerise "BELLIU" sh.p.k dhe te kontrates se shitjes nr.523/150 date 18.06.2002 te bere para noteres Andromaqi Berati per shitjen e kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise.
- Ndryshimin e nenit 15 te Statusit te Shoqerise (administrator i shoqerise "BELLIU" sh.p.k te jete z.Agron Hasanbelliu).

Urdherohet zyra e regjistrin tregtar te beje ndryshimet perkatese ne kollonen _____
Germa _____ dhe te beje ndarjen me vize te kuqe.

GJYQTARE

Shpresa Cafa
[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
Nr. 26827/2 Vendimi.

V E N D I M
I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 23/5/2003, une gjyqtaria e Gjykates se Shkalies se Pare Tirane, *A. Xhemcaj*, pasi shqyrtova kerkesen dhe dokumentat e paraqitura nga Shoqeria "BELLIU" Shpk Berat me ortak te vetem Z. AGRON HASANBELLIU, per depozitimimin e dokumentave per ndryshime ne statutin e shoqerise,

V E R E N

Shoqeria "BELLIU" Shpk Berat me ortak te vetem Z. AGRON HASANBELLIU, me Vendimin Nr. 26827 date 14.12.2001 te Gjykates se Rrethit Tirane, ndryshuar me Vendimin Nr. 26827/1 date 24.06.2002 te po kesaj gjykate, eshte regjistruar si person juridik qe fiton zotesine per te vepruar, per te ushtruar veprimtarine private te pershkruar hollesisht ne vendimin e kesaj gjykate.

Me Vendimin Nr. 2 date 16 Maj 2003 te Ortakut te Vetem te Shoqerise, eshte vendosur si me poshte :

Te shtohet aktiviteti i Shoqerise edhe ne kete fushe :

1. Ne fushen e ndertimit sipas kategorive si me poshte :

- kat. 1 : punime dheu, sistemime, tarracime terrenesh, etj.
- kat. 2 : a. prodhim materiale inerte, rere, cakull, gure, mermer, etj. c. prodhim qeramike si tullat, tjegullat, fajance, gres dhe g. prodhim druri metalike, plastike etj. per dyer, dritare, kallepe, etj.
- kat. 3/a : ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore, etj. deri dy kate dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to.
- kat. 4/a : ndertim rruge kat. V, IV.
- kat. 6 : a, b ndertim vepra arti rrugore dhe hekurudhore.
- kat. 8/b : ndertime ujeshjelles e kanalizime.

- kat. 10/a : rikonstrukcione godinash civile, ekonomike , veçitje fasadash , etj.

- kat. 11/a : punime karpentjere druri.

2. Magazinimi ne depo i lendeve plasese dhe shperthyesesh dhe ruajtja e tyre . Perdorimi i lendeve plasese dhe shperthyesesh ne kryerjen e punimeve per hapjen dhe shfrytezimin e mineve dhe ne kariera e nentoke , per hapjen e rrugeve e punimeve te tjera te ndertimit .

Ti behet kerkese Gjykates se Rrethit Tirane per depozitimin e kerkeses dhe dokumentave te Shoqerise " BELLIU " Shpk Berat per te reflektuar ndryshimet ne statutin e shoqerise .

Nga dokumentat e paraqitura rezulton se kerkesa eshte e drejte dhe e bazuar ne ligj dhe si e tille duhet te pranohet .

PER KETO ARESYE

Ne mbeshtetje te Ligjit Nr. 7667 date 28 Janar 1993 ,


V E N D O S A

1. Pranimin e kerkeses .

2. Depozitimin e kerkeses dhe Vendimit Nr. 2 date 16 Maj 2003 te Shoqerise " BELLIU " Shpk Berat .

Te behen shenimet perkatese ne fleten e regjistrit prane kesaj gjykate .

G J Y Q T A R E :



URDHER REGJISTRIMI

26827

1.

2. a) " Bellia

" shpk

b) selia Ura Vajzurore, Berat

c) objekti Trepim me shumice e pakice,
import - eksport e artikujve te
ndryshem, transport mallrash e
parapjesech, shfrytezim perime siperfaqore.

c) leke 100.000
100 % ortaku I vetem

3. Administrator Gramoz Harunbelliu

4. Kohezgjatja mbi 10vjet.

Statut 11 flete

Akt themelimi 2 flete.

Data e nenskrimit 13.12 .2001

Data e regjistrimit 14/12 .2001

Konferme Bankare e leshuar nga Notove Numosa Shehu
date 12.12 .2001. me nr. 24 rep.

GJYQTARE

Albina Xhoxhaj





AKTI I THEMELIMIT I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR " B E L L I U " SHPK.

Ne Tirane, sot me date 10 Dhjetor 2001, une i nenshkruari **GRAMOZ HASANBELLIU**, i biri i Laverit dhe i Elenes, i datelindjes 26.06.1970, lindur dhe banues ne Berat, lagja "Kushtrimi" pall.166, shk.1, ap. 2, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, me cilesine e ortakut te vetem, me vullnetin tim te lire e te plote, vendosa te krijoj Shoqerine Private me Pergjegjesi te Kufizuar "**BELLIU**" SHPK.

H Y R J E

Ne kuptim te ketij akti themelues, ortakut i vetem **GRAMOZ HASANBELLIU** eshte themeluesia e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "**BELLIU**" SHPK.

Qellimi i ketij akti themelues eshte krijimi i Shoqerise "**BELLIU**" SHPK me qender ne Berat dhe me shtrirje ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj.

Shoqeria "**BELLIU**" SHPK Berat rregullon veprimtarine e saj ne perputhje me Aktin e Themelimit, Statutin e saj, me Ligjin Nr. 7638 date 19 Nentor 1992 "Per Shoqerite Tregtare ne Republikën e Shqiperise" dhe akte te tjera te legjislacionit shqiptar.

O B J E K T I

Objekti i veprimtarise private te Shoqerise "**BELLIU**" SHPK do te jete si me poshte:

- Tregtimin me shumice e pakice, import - eksport te artikujve te ndryshem industriale, ushqimore, bujqesore e blegtorale, pijeve alkoolike e freskuese, fruta perime, artikujve te ndryshem te konsumit te gjere, materiale ndertimi dhe hidrosanitare, makineri e pajisje e pjese kembimi per to perfshire ato elektrike, elektroshtepijake, etj.; Servis; Veprimtari ne fushen e transportit te ndryshem te mallrave dhe udhetareve.

- Shfrytezimi me punime sipersfaqesore (kariera) te gurit gelqeror dhe minerale te tjera per materiale ndertimi. Perpunimi ne linja thyerje e fraksionimi per prodhim rere, granil, cakell, etj. Tregtimi i gurit gelqeror dhe minerale te tjera ne gjendje natyrale dhe te perpunuara.

G. Belliu



- 2 -

AFATI I VEPRIMTARISE

Veprimtaria e shoqerise do te jete efektive nga dita e regjistrimit ne regjistrin tregetar prane Gjykates se Rrethit Tirane .

Aktiviteti privat do te zhvillohet me nje afat te pacaktuar , mbi 10 vjet.

KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali themeltar i Shoqerise " **BELLIU** " SHPK Tirane perbehet nga kontributi fillestar i ortakut te vetem themelues **Z. GRAMOZ HASANBELLIU** i cili arrin ne vleren prej 100.000 leke .

Ortaku i vetem themelues ose persona te autorizuar prej tij kane te drejte qe me nxjerrjen e bilanceve periodike ose vjetore , te perfitojne perqindjet e realizuara nga veprimtaria private .

Shoqeria mban pergjegjesi per te gjitha detyrimet shteterore , sigurimet shoqerore , etj.

Per shkelje te ndryshme e te mundeshme te parashikuara ne statut , ortakut i vetem themelues mund te marre masa ndeshkimore ndaj kujtqdo qe demton pasurine e shoqerise .

JURIDIKSIONI

Shoqeria " **BELLIU** " SHPK e ka qendren tek Ura Vajgurure ne Berat .

Te gjitha mosmareveshjet me personat fizike e juridike , vendas e te huaj si dhe organet shteterore , zgjidhen me mirekuptim , ne te kunderten , zgjidhja e tyre mund te behet nga Gjykata e Rrethit Tirane .

THEMELUESI:

GRAMOZ HASANBELLIU
Gramoz Hasanbelliu
G.B. BELLIU



S T A T U T I

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

" B E L L I U " SHPK.

Ne baze te Ligjit Nr. 7638 date 19 Nentor 1992 "Per Shoqerite Tregtare ne Republiken e Shqiperise " dhe te akteve te tjera ligjore , ne Tirane , sot me date 10 Dhjetor 2001 , shtetasi shqiptar GRAMOZ HASANBELLIU , i biri i Laverit dhe i Hatemes , i datelindjes 26.06.1970 , lindur dhe banuese ne Berat , lagja " Kushtrimi " pall. 166, shk. 1 , ap.2 , madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar , me vullnetin e tij te lire e te plote , ne perputhje me legjislacionin shqiptar , vendosi te krijojte Shoqerine Private me Pergjegjesi te Kufizuar " B E L L I U " SHPK Berat .

K R E U I

DISPOZITA TE PERGJITHESHME

Neni 1

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar " B E L L I U " SHPK Berat eshte person juridik i pavarur , ka te drejta dhe detyrime per te cilat pergjigjet brenda kufijve te percaktuara ne Ligjin Nr. 7638 date 19 Nentor 1992 si dhe akteve te tjera ligjore .

Neni 2

Shoqeria e ushtron veprimtarine e saj private ne baze te ekonomise se tregut te lire .

Neni 3

Themeluesia e shoqerise ne kete sipermarje ka derdhur kapitalin e saj , me qellim qe te perfitoje te ardhurat qe mund te vijne nga veprimtaria private si dhe te perballoje humbjet deri ne kufirin e vleres se kontributit ne kapitalin fillestar .

GBecc/A



- 2 -

Neni 4

Shoqeria " **B E L L I U** " SHPK Berat eshte person juridik dhe fiton zotesine per te vepruar me regjistrimin ne Gjykatën e Rrethit te Tiranes dhe me pajisjen me lejen e ushtrimit te profesionit nga organi kopetent .

EMRI , QENDRA , TERITORI

Neni 5

Emertimi i Shoqerise do te jete :
Shoqeria Private me Pergjegjesi te Kufizuar " **B E L L I U** " SHPK Berat .

Neni 6

Selia e Shoqerise do te jete tek Ura Vajgurore ne Berat .
Shoqeria mund te zhvilloje aktivitetin e saj ne te gjithe teritorin e Republikës se Shqiperise dhe jashte saj .

O B J E K T I

Neni 7

Objekti i veprimtarise se kesaj shoqerie do te jete :

- Tregtimin me shumice e pakice , import - eksport te artikujve te ndryshem industriale , ushqimore , bujqesore e blegtorale , pijeve alkoolike e freskuese , fruta perime , artikujve te ndryshem te konsumit te gjere , materiale ndertimi dhe hidrosanitare , makineri e pajisje e pjese kembimi per to perfshire ato elektrike , elektroshtepijake , etj . ; Servis ; Veprimtari ne fushen e transportit te ndryshem te mallrave dhe udhetareve .

- Shfrytezimi me punime siperfaqesore (kariera) te gurit gelqeror dhe minerale te tjera per materiale ndertimi . Perpunimi ne linja thyerje e fraksionimi per prodhim rere , granil , cakell , etj . Tregtimi i gurit gelqeror dhe minerale te tjera ne gjendje natyrale dhe te perpunuara .

AFATI I VEPRIMTARISE

Neni 8

Aktiviteti privat i shoqerise do te zhvillohet me nje afat te pacaktuar , mbi 10 vjet .

G. Belet

Neni 9

*Shoqeria eshte e detyruar te mos e ndryshoje destinacionin e saj .
Ndryshimi i destinacionit te veprimtarise ekonomike financiare , mund te behet me
lejen e organeve perkatese .*

KAPITALI I SHOQERISE

Neni 10

*Kapitali themeltar i Shoqerise " B E L L I U " SHPK perbehet nga
kontributi fillestar i themeluesit te shoqerise ne vleften prej 100.000 leke .*

*Kapitali mund te rritet me zhvillimin e veprimtarise ekonomike
financiare te shoqerise .*

Neni 11

*Transferimet e kapitalit themeltar duhet te vertetohen me akt noterial .
Shoqeria apo te tretet duhet te respektojne keto transferime sapo ti behen te ditura
asaj .*

Neni 12

*Pjeset e kapitalit themeltar jane te transferueshme ne rruge
trashegimie . Ato mund tu kalojne bashkeshorteve , paraardhesve dhe pasardhesve .*

Neni 13

*Pjese te kapitalit themeltar mund ti transferohen edhe personave te trete,
qe nuk bejne pjese ne shoqeri, me pelqim te themeluesit te shoqerise, ne rast te shtimit te
numrit te ortakeve qe perfaqesojne te pakten 3/4 e pjeseve te kapitalit themeltar .*

Neni 14

*Ne rast te shtimit te numrit te ortakeve, me mareveshje, pjeset e kapitalit
themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet tyre .*

GBelliu

DREJTIMI ADMINISTRATIV

Neni 15

Shoqeria " **B E L L I U** " SHPK Berat do te kete si administratore **Z. GRAMUZ HASANBELLIU** .

Themeluesi i shoqerise ka ne kopetence te caktoje si administrator edhe personu te tjere te cilet nuk kane cilesine e ortakut .

Neni 16

Administratori ka per detyre organizimin dhe drejtimin e shoqerise . Ai mund te kryeje te gjitha veprimet e administrimit ne interes te shoqerise .

Neni 17

Ne maredhenie me te tretet administratori angazhon shoqerine nepermjet akteve , qe jane ne perputhje me objektin e saj . Ne rastet kur administratori eshte i emeruar nga themeluesi i shoqerise , kryen te gjitha veprimet e administrimit te shoqerise , me perjashtim te atyre qe jane ne kopetencen e themeluesit te shoqerise .

Neni 18

Ortaku i vetem themelues ka ne kopetence :

- * Te miratoje programin e shoqerise, te hartoje raportin e administrimit, inventaret, llogarite vjetore , te cilat hartohen brenda nje afati 6 mujor, duke filluar nga data e mbylljes se vitit financiar .
- * Vendos per shperberjen e shoqerise .
- * Vendos per ndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve .
- * Rregullon maredheniet e punesimit e te shperblimit brenda shoqerise .
- * Sipas akteve ligjore shlyen detyrimet ndaj organeve shteterore, personave juridike e fizike, vendas a te huaj .
- * E te tjera .

GBeccaf.

Neni 19

Ne rast se administrimi i shoqerise kryhet nga nje administrator i zgjedhur posacerisht nga ortakut themelues, ky i fundit miraton aktet e administrimit brenda afateve te mesiperme dhe ka te drejte te informohet personalisht per veprimtarine e shoqerise si dhe te njihet me llogarite dhe dokumentat e shoqerise .

Neni 20

Administratori humbet detyren e ngarkuar ne rast te prishjes se shoqerise ose kur shkarkohet nga ortakut i vetem themelues i shoqerise . Ne rastin e fundit, shkarkimi i administratorit behet ne baze te nje akti me shkrim te themeluesit te shoqerise . Ne rast se shkarkimi behet pa te drejte , ai le shkak per demshperblim financiar .

K R E U II

MAREDHENJET EKONOMIKE FINANCIARE

Neni 21

Shoqeria " B E L L I U " SHPK mund te lidhe kontrata me sektoret shteterore , drejtperdrejt me tregun e lire si dhe me persona juridike e fizike , vendas a te huaj , sipas legjislacionit ne fuqi per eksport importet .

Neni 22

Ne veprimet kontraktuale shoqeria perfaqesohet nga Z. GRAMAZ HASANBELLIU ose persona te tjere te autorizuar prej tij .

Neni 23

Te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga kontratat jane te detyrueshme per shoqerine dhe punonjesit e saj .

Gramaz H.

Neni 24

Sipas rregullave të caktuara nga Ministria e Financave dhe akteve të tjera ligjore, shoqëria përgjigjet për kontributin fiskal, afatet e derdhjes së tij, detyrimet ndaj shtetit, sigurimet shoqërore, etj. Sipas ligjit të tatimit mbi fitimin përcaktohen tatimet për veprimtarinë tregëtare të shoqërisë .

Shoqëria ka të drejtë të cele llogari likuiduese pranë bankave të vendit, të huaja e Shqipëri dhe të kryejë veprimet e likuidimit nëpërmjet tyre .

Neni 25

Për sigurimin e veprimtarisë ekonomike, shoqëria ka të drejtë të vefinacohet në leke ose valute të huaj .

Neni 26

Shkëmbimi i monedhës shqiptare me monedhe të huaj e anashjelltas, mund ta bëjë në përputhje me kursin e caktuar nga Banka e Shtetit Shqiptar ose me tregun e lirë privat të valutes .

Neni 27

Te ardhurat nga veprimtaria private do të sigurohen sipas cmimeve që i cakton vetë shoqëria. Cmimet dhe tarifatat do të caktohen sipas kërkesës dhe ofertes .

Neni 28

Shoqëria ka të drejtë të transferojë jashtë shtetit kapitalin dhe pjesën e saj të fitimit në valute. Për pjesën e fitimit që transferohet jashtë shoqëria paguan një tatim të përcaktuar në dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar .

Neni 29

Për pasqyrimin e aktivitetit tregëtar administratori ose persona të tjerë të caktuar nga ortaku i vetëm themelues, janë të detyruar të mbajnë dokumentacion të rregullt financiar dhe regjistrat përkatës sipas ligjit të vecantë .

Geçez



- 7 -

Neni 30

Veprimtaria ekonomike e shoqerise mbaron ne muajin Dhjetor te cdo viti. Administratori eshte i detyruar te paraqese bilance periodike, bilance vjetore se bashku me deklaraten e fitimeve dhe humbjeve dhe ti depozitoje ato ne organin financiar te juridiksionit financiar te juridiksionit perkates ku ushtron aktivitetin shoqeria

K R E U III

MAREDHENIET E PUNESIMIT

Neni 31

*Themeluesia e shoqerise vendos per shtimin ose pakesimin e numrit te ortakëve dhe personave te tjere qe do te punesohen ne veprimtarine e Shoqerise " **BELLIU** " SHPK.*

Neni 32

Maredheniet e punesimit brenda shoqerise rregullohen sipas kontrates qe lidhet lirisht midis paleve. Kontrata leshohet nga administratori i shoqerise pasi te jete marre me pare pelqimi i themeluesit te shoqerise , ose nga vete ortaku themelues qe ka edhe detyren e administratorit .

Neni 33

Marrja ne pune nga punedhenesi behet me regjistrimin e punonjesve ne librin e punes se shoqerise, si dhe duke njoftuar organet e punes te juridiksionit ku e ushtron aktivitetin shoqeria .

Neni 34

Ortaku i vetem, ortakët ne rast se shtohet numri i tyre, administratori dhe punojesit e tjere te shoqerise, jane te detyruar te respektojne disiplinen e punes dhe mbajne pergjegjesi per thyerjen e saj .

G. Belliu

Neni 35

Ndaj personave qe demtojne prone e shoqerise zbatohen masa ndeshkimore te cilat percaktohen nga themeluesi i shoqerise dhe ne mungese te tyre zbatohen dispozitat e Kodit te Punes te Republikes se Shqiperise .

Neni 36

Kontrata e punes mund te lidhet me ose pa afat te caktuar, sipas kritereve te caktuara nga ortaku i vetem themelues ose nga ortaket kur jane disa te tille dhe ne mungese te parashikimeve ne kontrate, sipas ligjeve te shtetit shqiptar .

Neni 37

Punonjesit e gezojne lejen vjetore dhe lejen plotesuese sipas kritereve te percaktuara ne kontraten e punes dhe ne mungese te tyre , sipas Kodit te Punes te Republikes se Shqiperise .

Neni 38

*Ndryshimi dhe largimi nga vendi i punes behet ne baze te nje akti me shkrim te leshuar nga ortaku themelues **Z. GRAMOZ HASANBELLIU** . Largimi lidhet me mbarimin e kontrates se punes, per shkak te shkeljeve disiplinore ose me vete kerkesen e te interesuarit .*

Neni 39

Punonjesi qe largohet ose transferohet ne nje pune tjetër , duhet te dorëzojë detyren ne baze te nje akti me shkrim, pasi te kete likuiduar detyrimet materiale dhe monetare. Akti i mesipermbahet nga administratori i shoqerise .

ELEMENTE TE TJERA

Neni 40

Per zhvillimin dhe zgjerimin e veprimtarise ekonomike tregtare, shoqeria mund te marre truall per ndertim me qira ose ne pronesi, si dhe objekte te ndertuara sipas nje kontrate te vecante .

G. Belliu



- 9 -

Neni 41

Dhenja e truallit dhe e objekteve dhe vlefia perkatese e tyre percaktohen nga organi financiar ne juridiksionin e te cilit ndodhet objekti ose trualli, ne baze te kriterëve te Keshillit te Ministrave dhe sipas kerkeses e ofertes ne mareveshje me persona juridike e fizike vendas .

BILANCI DHE TE ARDHURAT

Neni 42

Te ardhurat neto, pas shlyerjes se detyrimeve fiskale, sigurimet shoqerore, etj. kalojne ne pronesi te ortakut te vetem themelues ose te ortakeve ne se ka te tille dhe ndahen sipas kontributit te sejcilit .

Neni 43

Shperblimi per administratorin dhe personat e punesuar ne veprimtarine e Shoqerise " BELLIU " SHPK Berat , caktohet sipas kontrates se punes . Ndryshimi ne page vendoset nga themeluesia e shoqerise ose nga ortakët , ne rast se shtohet numri i tyre .

Neni 44

Shoqeria perballon humbjet vetem deri ne kufirin e vleres se kontributit te tyre fillestar ne kapitalin baze .

Neni 45

Fitimi qe do te shperndahet perbehet nga fitimi i vitit financiar, te cilit i jane zbritur ose shtuar numrat respektive te humbjeve apo fitimeve te hartura nga vitet e mepareshme .



- 10 -

Neni 46

Kur pushon aktiviteti i shoqerise, kapitali i mbetur , pasi shlyen te gjitha detyrimet, ndahet midis ortakeve sipas kontributit te sejcilit ose i mbetet ortakut te vetem themelues kur nuk ka te tjere .

Neni 47

Fitimi i mbetur kalon ne pronesi te ortakut te vetem themelues pasi jane shlyer te gjitha detyrimet tatimore si dhe pagesat e mundeshme per punonjesit e shoqerise. .

SHIPERBERJA E SHOQERISE

Neni 48

Ne rast se kapitalet e shoqerise per shkak te humbjeve te konstatuara ne dokumentat financiare rezultojne me te vogla se gjysma e kapitalit themeltar, ortaku themelues vendos brenda 4 muajve nga dita e konstatimit mbi mundesine e prishjes se parakoheshme te shoqerise dhe mund te kerkoje ne gjykate prishjen e saj .

Neni 49

Gjykata mund ti afroje shoqerise nje afat maksimal prej 6 muaj per te rregulluar gjendjen. Ajo nuk mund te prishe shoqerine ne rast se ky rregullim eshte bere ne ditën ne te cilen ajo mbliidhet per te marre vendim .

Neni 50

Ne rast se shoqeria nuk prishet, detyrohet te zvogeloje kapitalin e saj ne nje vlere jo me te vogel se ajo e humbjeve qe ka mbetur pa mbuluar , duke putur parasysh qe shumua e kapitalit te mbetur te jete mbi 100.000 leke .

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 51

Themeluesi ne rastin e shtimit te numrit te ortakeve ka te drejten te beje ndryshimet e nevojeshme ne statut si dhe te hartoje dhe kontraten e perbashket me ortakët

GBezzi



- 11 -

e tjere , duke bere ndryshimet e nevojeshme ne regjistrin tregtar prane Gjykates se Rrethit Tirane .

Neni 52

Mosmareveshjet e shoqerise ne maredhenie me persona juridike e fizike , vendas a te huaj , zgjidhen me mirekuptim , ne te kunderten , kur kjo nuk arrihet , zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tirane .

Neni 53

Persa nuk eshte shprehur ne kete statut i referohet Ligjit Nr. 7638 date 19 Nentor 1992 " Per Shoqerite Tregetare ne Republikën e Shqiperise " si dhe cdo akti tjeter te legjislacionit shqiptar .

Neni 54

Statuti perpilohet ne disa kopje per tju dorezuar organeve kopetente . Nje kopje e tij mbetet si pjese perberese e dokumentacionit te formimit te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar " **BELLIU** " SHPK Berat .

ORTAKU I VETEM

GRAMOZ HASANBELLIU
Gramoz Hasanbelliu
GBejA.

VENDIM NR.1
I ORTAKUT TE VETEM TE SHOQERISE "BELLIU" SH.P.K

Me vendimin numer 26827 date 14.12.2001 te Gjykates se Rrethit Tirane , eshte vendosur krijimi i Sh.p.k "BELLIU" me kapital fillestar 100.000 (njqindmije) leke Me objekt veprimtarie " Tregetim me shumice e pakice, import-export te artikujve te ndryshem industrial, ushqimor, bujqesor, e blektoral, pijeve alkoolike e freskuese, fruta-perime, artikujve te ndryshem te konsumit te gjere, materiale ndertimi dhe hidrosanitare, makineri e pajisje e pjese kembimi per to perfshire ato elektrike, elektro-shtepiake, etj; Servis ; veprimtari ne fushen e transportit te ndryshem te mallrave dhe udhetareve; shfrytezimi me punime siperfaqesore (kariere) te gurit gelqeror dhe minerale te tjera per materiale ndertimi ; perpunimi ne linja thyerje e fraksionimi per prodhim rere ,granili, cakell etj; tregetimi i gurit gelqeror dhe minerale te tjera ne gjendje natyrale dhe te perpunuara".

Ne mbledhjen e sotme, une ortaku i vetem i shoqerise vendos qe te largohem nga shoqeria , duke shkeputur cdo mardhenie me shoqerine duke i shitur kapitalin themeltar prej 100.000 (njqindmije) lekesh z.Agron Hasanbelliu.

Keshtu,sot ne Berat, me date 18.06.2002,une ortaku i vetem i shoqerise "BELLIU" sh.p.

VENDOSA :

Largimin tim nga shoqeria , duke vazhduar si shoqeri me ortak te vetem z.Agron Hasanbelliu.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE
Gramoz HASANBELLIU



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE BERAT
NOTERE ANDROMAQI BERATI
Nr.529... Vep.

PULLE TAKSE



VERTETIM NENSHKRIMI

Sot, ne Berat, me date 18.06.2002, perpara meje noteres Andromaqi Berati, u paraqit personalisht Gramoz Hasanbelliu, i biri i Laverit, i datelindjes 26.06.1970, banues ne Berat, me zotesi te plote juridike per te vepruar, i panjohur prej meje, me dentitetin e te cilit u njoha konform pasaportes se tij personale, me cilesine e ortakut te vetem te shoqerise "BELLIU" sh.p.k, i cili deklaroi se ka nenshkruar rregullisht, me vullnetin e tij te lire, jashte kesaj zyre noteriale, dokumentin e mesiperme, Vendim numer 1 ,date 18.06.2002. Une noterja vertetoj deklarimin e tij.

NOTERE
Andromaqi Berati



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE BERAT
NOTERE ANDROMAQI BERATI
Nr. ...523..... vep. Nr. ...120.....kol.



KONTRATE SHITJE
E KAPITALIT THEMELTAR TE SHOQERISE

Sot ne Berat , me date 18.06.2002, perpara meje noteres Andromaqi Berati, u paraqiten personalisht palet kontraktuese :

SHITESI – GRAMOZ HASANBELLIU, i biri i Laverit, i datelindjes 26.06.1970, banues ne Berat, me zotesi te plote juridike per te vepruar, i panjohur prej meje, me identitetin e te cilit u njoha konform pasaportes se tij personale .

BLERESI- AGRON HASANBELLIU, i biri i Laverit, i datelindjes 10.01.1960, banues ne Berat, me zotesi te plote juridike per te vepruar, i panjohur prej meje, me identitetin e te cilit u njoha konform pasaportes se tij personale.

... te cilet kerkuan redaktimin dhe legalizimin e kontrates se shitjes si me poshte vijon :

Shitesi Gramoz Hasanbelliu, ne baze te Statusit te Shoqerise "BELLIU" sh.p.k, Aktit te themelimit dhe Vendimit numer 26827 date 14.12.2001 te Gjykates se Rrethit Tirane, eshte ortak i vetem i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar te quajtur "BELLIU" sh.p.k., duke qene pronar i 100% te kuotave me kapital themeltar 100.000 (njeqindmije) leke.

Shitesi Z.Gramoz Hasanbelliu, deklarone se 100% te kuotave te kapitalit themeltar te tij me vlere 100.000 (njeqindmije) leke , ia shet bleresit Z.Agron Hasanbelliu.

Nga ana e tij, bleresi z.Agron Hasanbelliu, deklarone se i blen z.Gramoz Hasanbelliu 100% te kuotave te kapitalit themeltar te tij me vlere 100.000 (njeqindmije) leke .

Palet deklarojne se shuma prej 100.000 (njeqindmije) leke ,qe perben 100% te kapitalit te shoqerise , eshte likujduar jashte kesaj zyre noteriale.

Keshtu, me nenshkrimin e kesaj kontrate , z.Gramoz Hasanbelliu , humbet pronesine mbi kapitali themeltar te shoqerise, ndersa z.Agron Hasanbelliu, behet pronar i gjithe kapitalit te shoqerise "BELLIU" sh.p.k, ne vlere leku 100.000 (njeqindmije) leke si dhe ortaku i vetem i saj.

Kontrata si u lexua dhe u pa se ishte e njejte me vullnetin e lire te paleve, u nenshkrua rregullisht prej tyre. Une noterja e vertetoj ate.

SHITESI

Gramoz Hasanbelliu

BLERESI

Agron Hasanbelliu
ABelliu

NOTERE
Andromaqi Berati

SHOQERIA "BELLEJU" SHPK
BERAT



V E N D I M
I ORTAKUT TE VETEM
Nr. 2 date 16 Maj 2003

Net me date 16 Maj 2003, Shoqeria "BELLEJU" SHPK Berat, me ortak te vetem AGRON HASANBELLIU, e regjistruar si person juridik me Vendimin Nr. 26827 date 14.12.2001 te Gjykates se Rrethit Tirane, ndryshuar me Vendimin Nr. 26827-I date 24.06.2002 te dhene nga ana e po kesaj gjykate, duke marre ne analize kerkesat e Ligjit Nr. 7367 date 28 Janar 1995 si dhe duke parur parasysh nenet perkatese te statutit te Shoqerise .

V E N D O S I

Te shihet aktiviteti i Shoqerise edhe ne kete fashë:

1. Ne fashen e nderimiti sipas kategorive si me poshte:
 - kat. 1 : punime dheu, sistemime, terracime terrenesh, etj.
 - kat. 2 : e prodhim material: inerte, rere, cakull, gura, mermer, etj. e prodhim qeramike si tulla, tegulla, fajance, gres dhe g. prodhimet druri metalike, plastike etj. per dyer, dritare, kallepe, etj.
 - kat. 3 a : ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore, etj. deri dy kate dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to.
 - kat. 4 a : ndertim rruge kat. V, IV.
 - kat. 6 : a, b nderim vepra arti rrugore dhe hekurudhore.
 - kat. 8 b : ndertime ujeshjelles e kanalizime.
 - kat. 10 a : rikonstruksione godinash civile, ekonomike, veshje fasadash, etj.
 - kat. 11 a : punime karpentjere druri

2 Magazinimi ne depo i ranceve prasese dhe shperthyese dhe



KONTRAT PUNE

Ne Berat sot me 16.05. 2003 para meje noterit Luan Isufaj

U paraqiten personalishte palet :

PUNEDHENESI FIRMA "BELLIU" sh.p.k. me qender ne Ura-Vajgurore Berat perfasuar nga z.AGRON HASANBELLIU I biri I Laverit dtl 10.01.1960 banues ne Berat madhor me zotesi te plote per te vepruar.I njohur nga noteri

PUNEMARESI EMILJANO ZHULEKU I biri I Hysenit dtl 30.06.1973 banues ne Berat madhor me zotesi te plote per te vepruar.I njohur nga noteri-----

Palet madhor me zotesi te plote per te vepruar me vulnetin e tyre te lire e te pavesuar lidhin para meje noterit publik kete kontrat pune si me pshte vijon

Punemaresi do te kryeje punen e DREJTUES TEKNIK

Koha e punes do te jete tete ore ne dite per punene e kryer jashte ketij orari punemaresi shperblehet nga 20 % deri 50 % te pages ditore. Kur punemaresi punon ditet e pushimit javor dhe te festave zyrtare dhe nuk mer mer pushim nje dite tjeter te javes ne vazhdim,shperblehet me 25 % te pages ditore.Ky rregull vlen per rastet kur puna ne ditet e pushimit eshte kerkuar nga punedhenesi.Paga do te llogaritet mujore e cila do te jete ne shumen 120.000 /njezetmije/ lek dhe do te paguhet cdo pesmbedhjet dite.

Detyrimet e Punedhenesit:

1. Te siguroje kushtet e domosdoshme te punes
2. Te paguaje detyrimet shtetore per sigurimet shoqerore
3. Te njohe te drejten e lejes se zakoneshme jo me pak se 15 dite pune ne vit.

Detyrimet e Punemaresit:

1. Te zbatoje disiplinen e punes
2. Te pergiegjet per cilesine e sasine e punes se kryer
3. Te ruaje e mirembaje vendin e mjetet e punes
4. Te pergiegjet per demet e shkaktuara ne pune ne baze te Kodit te Punes

Kjo kontrate eshte e vlefshme per nje periudhe kohe prej Nje vjecare duke I filluar efektet e sajje juridike nga data 16.05.2003.-----

-Te dy palet marin persiper detyrimin e zbatimit me perpikmeri te kesaj kontrate.Per mosmarveshjet e lindura gjate zbatimit te kesaj kontrate do te bisedohet mes paleve.Ne raste se nuk arrihet mirkuptimi palet mund ti drejtohen Gjykates kopetente

Kjo kontrate u perpilua nga nga une noteri publik ne tre kopje me vlere te njejte ligjore dhe pasi u lexua nga palet dhe u gjet ne perputhje te plote me vulnetin e tyre te plote e te lire neshkruhet dhe vertetohet nga une noteri konform ligjit.

PUNEDHENESI

PUNEMARESI

NOTERI

Agrou Hasanbelliu Emiljano Zhuleku
A Belliu

Luan Isufaj

F. Belliu SHPK
EKS - IMP
Berat Albania

23
05.16

L I C E N S E.

Z. Emiljano Hysen Zhuleku, lindur me 30.06.1973, ne Berat,
me profesion inzhinier ndertimi, diplomuar ne vitin 1996, ne
Fakultetin e Inzhinjerise se Ndertimit, dega ndertim, bashke me
Berat, E. "Cilirim".

Ne baze te kerkeses dhe te dhenave disponuese te teper license
per shanim, dhe regjistruhet ne regjistrin qendror te shanimit,
ne qytetin e Beratit, per kategorit e:

- Kat. 1 - punime dhe sisteme teknike terrenesh etj.
- Kat. 2 - a, c, g
- Kat. 3/a - ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore
etj deri dy kate dhe komunalitetet bashkitare
- Kat. 4/a - ndertim krage kat. V, IV.
- Kat. 6 - a, b ndertim vepra arti rrugore dhe hekurudhore
- Kat. 8/b - ndertime ujeshjellesh e kanalizime.
- Kat. 10/a - rikonstruksione godimesh civile, e ekonomike,
veshje fasadash etj.

QIRBAK ZALLOTA

KOMISIONI I DHENIES SE LICENSAVE

Shenim: Kjo license eshte e vlefshme deri me daten 13.04.2004

AVOKAT
ARENÇ BERATI
BERATI,

26827/1

24.06.02

3 A Copo

24 06 2002



K E R K E S E

KERKUESI – Gramoz Hasanbelliu, i biri i Laverit, i datelindjes 26.06.1970, banues ne Berat, me cilesine e administratorit dhe ortakut te vetem te shoqerise “BELLIU” sh.p.k.

OBJEKTI - Depozitimi i vendimit numer 1 date 18.06.2002, te Ortakut te vetem te shoqerise “BELLIU” sh.p.k dhe te kontrates se shitjes numer 523/150 date 18.06.2002 te bere para noteres Andromaqi Berati per shitjen e kuotave te kapitalit themeltar te kesaj shoqerije.

GJYKATES SE RRETHIT TIRANE

Z.Gjyqtar!

Me vendimin numer 26827 date 14.12.2001 te Gjykates se Rrethit Tirane, eshte vendosur krijimi i shoqerise “BELLIU” Sh.p.K me kapital themeltar 100.000 (njqindmije) leke.


Me vendimin numer 1 date 18.06.2002 te Asamblese se Shoqerise , me kontraten e shitjes 523/150 date 18.06.2002, perpara noteres Andromaqi Berati, une Gramoz Hasanbelliu largohem nga shoqeria duke ia shitur kapitalin themeltar te shoqerise (100% te kuotave) z. Agron Hasanbelliu.

Ne keto kushte i kerkoj Gjykates se Rrethit Tirane :

-Depozitimin e Vendimit numer 1 date 18.0.2002 te Ortakut te vetem te Shoqerise “BELLIU” sh.P.K

-Depozitimin e kontrates numer 523/150 date 18.06.2002 se shitjes se kuotave te kapitalit themeltar te kesaj shoqerie duke u bere ndryshimet perkatese ne fleten perkatese te Rregjistrimit Tregtar te Gjykates se Rrethit Tirane.


ADMINISTRATORI
Gramoz Hasanbelliu



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr. 24 Rep.

V E R T E T I M

Vertetohet se sot me date 12 Dhjetor 2001 (dymije e nje) Z. GRAMOZ HASANBELLIU , depozitoi prane meje noteres ne Mimoza SHEHU ne Tirane , vleften prej 100.000 leke (njeqint mije) , vlefte e cila perfaqeson kapitalin themeltar te krijimit te kesaj shoqerie .



N O T E R E :

N O T E R E
MIMOZA SHEHU
NR. FILLI ZYDE
:271-25

Handwritten signature